




REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASENIT UJOR SHKUMBIN

VENDIM
Nr.26, datë 19.12.2024



PËR
**MIRATIMIN E KËRKESËS PËR TRANSFERIM TË LEJES, NGA
SUBJEKTI “SH.A UJËSJELLËS KANALIZIME LIBRAZHD” TEK
“SHOQËRIA RAJONALE UJËSJELLËS KANALIZIME ELBASAN”.**

Në mbështetje të shkronjës “b” të pikës 2, të nenit 41, të ligjit nr.111/2012, “Për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore”, i ndryshuar dhe të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.550, datë 15.07.2020, “Për miratimin e formularëve të kërkesës për miratimin, në parim për dhënien me koncension të përdorimit të burimit ujor, e lejes/autorizimit për përdorim burimi ujor, veprimtari ndërtimore në brigje, veprimtari në shtratin e burimit ujor, shkarkime të lëngshme, përdorimin dhe ripërdorimin e ujrave të pëdorura, të ndotura, të dokumenteve shoqëruese, të procedurës së shqyrtimit e të vendimarrjes, të formateve të lejes, të autorizimit, të kushteve të posaçme dhe të afateve të vlefshmërisë së tyre”, me propozimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore, Këshilli i Basenit Ujor Shkumbin,

V E N D O S I:

1. Miratimin e kërkesës për transferimin e lejes Nr.A 3, datë 5.5.2009 “Leje për përdorim të rezervës ujore e lidhje kontrate, për furnizim të popullatës me ujë të pijshëm, nga Sh.A.Ujesjelles Librazhd,

Nga subjekti “SH.A Ujësjiellës Kanalizime Librazhd” me Nipt J68122606V tek subjekti “Shoqëria Rajonale Ujësjiellës Kanalizime Elbasan” sh.p.k me Nipt M23322201V.

2. Treguesit paraprakë janë si më poshtë

Emërtimi i burimit	KOORDINATAT KRGJSH		Q
	X	Y	l/s
Burimi i Kusarit në Qarrishtë	539562.76	4570729.66	4.4
	539570.04	4570726.3	4.4
	539563.32	4570721.26	4.4
	539556.04	4570725.46	4.4
Burimi Gurra e Faqollit në Spathar	528481.551	4557689.645	5



Burimi Gurra e Zezë në Dardhë	531982.332	4554298.275	1.2
Burimi Nerlakra, Shersi, Sharra në Hotolisht	536595.599	4560244.286	1.2
Burimi Nermolla	536484.059	4560228.666	1
Burimi Mali Dardhë	531233.484	4553518.194	0.2
Burimi Ulok Kuturmanë	522089.406	4563718.425	0.72
Burimi Gajor 1	523848.215	4554819.457	4
Burimi Gajor 2	523128.416	4554268.314	8

3. Ngarkohet Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas zbardhjes formalisht dhe njoftimit të subjektit të interesuar.

KRYETARI I KBU SHKUMBIN

ALI MYSLIU

